



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

Kuvendi i Komunës  
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-31227 /2025  
Kaçanik, 22.12.2025

#### FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e I-r (parë) të rregullt të Legjislaturës së 8 të Kuvendit të Komunës Kaçanik, për vitin 2025.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 30 dhjetor 2025 (e martë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit  
Selajdin Troni

Në mbledhjen e I-r (parë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, të 30.12.2025, do të shqyrtohet ky:

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës i datës 08.12.2025;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga Vazhdimi i mbledhjes Inauguruese të Kuvendit të Komunës të datës 08.12.2025, mbajtur me 18.12.2025;
3. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
4. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;
5. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026;
6. Kërkesë e DSHPE për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 104/02-22117/25 të datës 11.09.2025 për Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;
7. Propozim Vendim për Aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2026 nga lista e përgjithshme e pronave komunale;
8. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për lehonat në komunën e Kaçanikut.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik  
-Sektori i Kuvendit-

01Nr. 60/01-30749/2025  
Kaçanik, 18.12.2025

### PROCESVERBAL

Nga Vazhdimi i mbledhjes Inauguruese (Konstituive) e Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 08 Dhjetor 2025, mbajtur me 18.12.2025.

Mbledhja u mbajt në katin e III (Tretë) të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës;

- 21 Anëtarë e zgjedhur të Kuvendit të Komunës,
- Kryetari i komunës, Sabedin Vishi,
- drejtorët aktual të drejtorive komunale,
- Zyrtarë komunal,
- Përfaqësues nga shoqëria civile (OJQ),
- Qytetarë të komunës.

Mbledhjen e ka ftuar Kryetari i Komunës, Sabedin Vishi, ndërkaq e udhëheqë anëtari me i vjetër i KK, Xhelal Dema.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, ZLPKK.

Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë. Nga MAPL mbledhja monitorohet nga distanca nga zyrtari Nehat Uka.

Mbledhjen e hapi dhe e udhëheqë deri me zgjedhjen e Kryesuesit të KK, Xhelal Dema, i cili fillimisht i përshëndeti anëtarët e zgjedhur të KK, Kryetarin e Komunës Sabedin Vishi dhe pjesëmarrësit tjerë të kësaj mbledhje, duke iu dëshiruar mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 21 anëtarë të gjithë. Vazhdojmë me pikët e mbetura sipas këtij

#### Rendi Pune

6. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
7. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës; dhe
8. Mbyllja e mbledhjes.

#### 6. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i mbledhjes -Xhelal Dema: Në mbledhjen e kaluar datës 08.12.2025, e kemi formuar komisionin për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të komunës në përbërje:

1. Bashkim Krasniqi nga PDK
2. Ernesta Krasniqi nga LVV; dhe
3. Hafize Sallahi nga AAK.

A jeni të pajtimit me këtë përbërje të komisionit, apo e plotësojmë edhe me 2 anëtarë tjerë?

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Pasi përshëndeti anëtarët e KK, Kryetarin e Komunës dhe të pranishmit tjerë që janë në sallë dhe ata që po na përcjellin live, ne LVV jemi parimor dhe mbështetim themelimin e institucioneve, mirëpo nuk e mbështetim mënyrën e dobët

të organizimit siç ishte seanca inauguruese, ku nga paaftësia juaj, nuk i kishit siguruar numrat e nevojshëm për formimin e tyre, duke iu dështuar pazaret politike. Qytetarë të dashur që po na ndiqni, tash po merr kuptim ajo shfaqja teatrale nga seanca e kaluar. Grupi i anëtarëve të LVV, qëndron i palëkundur kundër këtyre pazareve, dhe iu bëjmë me dije qytetarëve se do të jemi një opozitë e fortë dhe qëndrueshme, duke kërkuar llogaridhënie dhe transparencë për çdo proces dhe vendimmarrje. Pra, jemi këtu të palëkundur për me mbrojtur interesin publik.

**Kryesuesi i mbledhjes -Xhelal Dema:** Edhe pse nuk ishte kjo temë e diskutimit, por e shfrytëzove të drejtën tuaj. Vazhdojmë, a jeni për komisionin që është zgjedhur, apo e shtojmë numrin edhe për 2 anëtarë nga subjektet tjera politike.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Komisioni është votuar, a është i ligjshëm ai komision? Nëse komisioni është i ligjshëm, atëherë vazhdojmë me komisionin e formuar.

**Kryesuesi i mbledhjes -Xhelal Dema:** Komisioni është votuar dhe është i ligjshëm, atëherë e aktivizojmë komisionin e zgjedhur të datës 08.12.2025.

1. Bashkim Krasniqi nga PDK
2. Ernesta Krasniqi nga LVV; dhe
3. Hafize Sallahi nga AAK.

Meqë e kemi komisionin e formuar, atëherë shkojmë me propozime konkrete për kandidatë për Kryesues të Kuvendit të Komunës nga subjektet politike të përfaqësuara në KK, duke filluar nga subjekti me i madh politik-PDK. Kërkoj nga subjekti politik i PDK të propozoj një kandidatë për Kryesues të Kuvendit.

**znj. Dardana Tafili-Dauti:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit dhe atyre që po na ndjekin live këtë seancë shumë të rëndësishme për qytetin e Kaçanikut, njëkohësisht edhe për ne si anëtarë të KK. Ne si PDK, e propozojmë për Kryesues të Kuvendit të Komunës, Selajdin Troni-anëtar i KK nga Partia Demokratike e Kosovës.

**Kryesuesi i mbledhjes -Xhelal Dema:** A ka propozim nga LVV për Kryesues të Kuvendit të Komunës ?

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Ne grupi i anëtarëve të KK nga LVV, konfirmojmë se nuk kemi propozim për Kryesues të Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i mbledhjes -Xhelal Dema:** Vazhdojmë me subjektin politik të LDK. A keni ndonjë propozim për Kryesues të Kuvendit të Komunës?

**znj. Ardita Rrahmani:** Ne grupi i anëtarëve të KK nga LDK, konfirmojmë se nuk kemi propozim për Kryesues të Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i mbledhjes -Xhelal Dema:** Vazhdojmë me subjektin politik, Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut. A keni ndonjë propozim për Kryesues të Kuvendit të Komunës?

**z. Kjani Zeneli:** Ne si Grup i Vizionit për Zhvillimin e Kaçanikut, nuk kemi kandidatë për Kryesues të Kuvendit të Komunës, ndërkaq duke marrë parasysh se kandidati i propozuar nga PDK - dega në Kaçanik, ne Selajdin Troni, duke ditur se kush është dhe nga kush vjen, afërsia janë me të, është fëmijë i dëshmorit, është këshilltar i mirë, vota e Vizionit për Zhvillim Ekonomik shkon për kandidatin Selajdin Troni.

**Kryesuesi i mbledhjes -Xhelal Dema:** Vazhdojmë me subjektin politik, AAK, keni ndonjë propozim për Kryesues të KK?

**znj. Hafize Sallahi:** Përshëndetje për të gjithë, qytetarët e Kaçanikut dhe juve të pranishëm, të nderuar kolegë, konfirmoj se AAK nuk ka kandidat për Kryesues të Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i mbledhjes -Xhelal Dema:** Atëherë e aktivizojmë komisionin e formuar për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës, të formuar në mbledhjen e datës 08.12.2025.

Meqë u propozua kandidati Selajdin Troni nga Partia Demokratike e Kosovës, për Kryesues të Kuvendit të Komunës, atëherë kërkoj nga komisioni i formuar të filloj më udhëheqjen e procedurave zgjedhore. Procedurën e votimit e kryen komisioni i zgjedhur, deri në dhënien e rezultatit përfundimtar. Kutia e votimit dhe kabina janë siguruar për votim. Fletë-votimet do të përgatiten nga komisioni i formuar në bashkëpunim me zyrtaren e kuvendit. Atëherë e ftoj komisionin që se bashku me zyrtaren e KK të përgatitni materialin për votim.

**Komisionit për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e Kryesuesit** filloj me punën e vet me përgatitjen fletëvotimeve në bashkëpunim me zyrtaren e KK. Pas i përgatitën fletëvotimet, anëtarët e komisionit u kthyen në sallë të mbledhjeve, vazhduan me procedurën e votimit. Fillimisht u thirrën anëtarët e KK emër për emër nga anëtarja e komisionit, Ernesta Krasniqi ku secilit anëtar paraprakisht ia ofroj regjistrin për nënshkrim, pastaj fletëvotimet i vulosi anëtar Bashkim Krasniqi, iu jepte anëtarëve të KK, pasi nënshkrimin në regjistër, ndërkaq të kutia e votimit qëndrojnë Hafize Sallahi.

Pas përfundimit të procedurës së votimit, komisioni filloj me numërimin e votave. Numërimi u bë para anëtarëve të KK duke fokusuar secilin fletëvotim nga anëtarja e komisionit, Hafize Sallahi para anëtarëve të KK për shkak të transparencës. Në fund komisioni hartoi Procesverbalin i cili proces u plotësua nga anëtarja Ernesta Krasniqi dhe i njëjti pas nënshkrimin nga anëtarët e komisionit, u lexua nga anëtarja Hafize Sallahi.

Sipas Procesverbalit të komisionit, në Raundin e parë të votimit, raporti është si vijon  
Numri i anëtarëve me të drejtë vote është 21 anëtarë. Në votim kanë marrë pjesë: 21 anëtarë.

Vota të vlefshme, 21

Vota të pavlefshme, 0

Kandidati i propozuar Selajdin Troni nga Partia Demokratike e Kosovës –PDK, në Raundin e I-r (parë) të votimit ka marrë gjithsej 15 votë Për dhe 6 votë Kundër. Në bazë të këtij rezultati, Selajdin Troni zgjedhjet Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Procesverbali i nënshkruar nga komisioni iu dërgua Kryesuesit të mbledhjes Xhelal Dema së bashku me fletëvotimet.

**Kryesuesi i mbledhjes- Xhelal Dema:** E lexoj procesverbalin e komisionit si vijon:

Në bazë të raportit të komisionit, në rundin e I-r (parë) të votimit, kandidati Selajdin Troni nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK, ka marrë 15 votë Për, për me u zgjedhur Kryesues të Kuvendit të Komunës. Andaj mbi bazën e këtij rezultati të votimit të fshehtë që u zhvillua për zgjedhjen e kryesuesit të KK, del konstatimi se, Kuvendi i Komunës Kaçanik mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për zgjedhjen e Selajdin Troni nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK, në raundin e I-r (parë) të votimit, Kryesues i Kuvendit të Komunës Kaçanik.**

Kandidati Selajdin Troni ka marrë numër të mjaftueshëm të votave konform Udhëzimit Administrativ të MAPL 2009/1 të zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Mandati i Kryesuesit të KK është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës- 4 vjeçar.

E falënderoj Kuvendin e Komunës për durimin që pati për të më dëgjuar në udhëheqjen e pjesës time të mbledhjes, ndërkaq e ftoj, Kryesuesin e zgjedhur të Kuvendit të Komunës, Selajdin Troni që nga ky moment filloj më udhëheqjen e mbledhjes për pikët e mbetura, 7 dhe 8.

Kalojmë në pikën e 7;

## **7. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,**

**Kryesuesi i mbledhjes- Xhelal Dema:** E ftoj Kryesuesin e zgjedhur i Kuvendit të Komunës, Selajdin Troni të udhëheq me pikët 7 dhe 8 të mbledhjes.

**Kryesuesi i Kuvendit- Selajdin Troni:** I nderuari Kryetar i zgjedhur i komunës së Kaçanikut, z. Sabedin Vishi, të nderuar anëtarë të Kuvendit, përfaqësues të institucioneve lokale , shoqërisë civile, mediave dhe qytetarë të komunës së Kaçanikut, Të nderuara familje të dëshmorëve, veteranë e invalid të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Sot kemi privilegjin të jemi së bashku në këtë seancë të rëndësishme, por edhe riafirmojmë përgjegjësinë dhe përkushtimin tonë tonë për qytetarët e Kaçanikut. Detyra ime si Kryesues i Kuvendit të Komunës, është që të siguroj që ky institucion të funksionoj me transparencë, profesionalizëm dhe respekt të plotë për rregulloren, ligjin, mbi të gjitha për vullnetin e qytetarëve. Kuvendi i Komunës është zemra e vendimmarrjes demokratike, çdo debat që zhvillohet këtu, ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e komunës dhe ka ndikim në të ardhmen e fëmijëve tanë, prandaj ne kemi detyrim të punojmë me seriozitet të plotë. Detyra jonë nuk është të jemi përballë njëri tjetrit, por përballë sfidave të qytetarëve dhe bashkë ti japim përgjigje. Sot dua të ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit të vazhdojmë me punën, me bashkëpunim me të madh, dialog me konstruktiv dhe kulturë institucionale me të lartë, të vendosim shembullin e mirë për administratën dhe qytetarët. Në emër të Kuvendit të Komunës Kaçanik, ju njoftoj se do të vazhdojmë të punojmë për zhvillimin e komunës tonë, për një Kaçanik modern, me shërbime cilësore dhe perspektivë të qartë për rininë. Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe angazhimin tuaj të përditshëm. Zoti e bekoftë Kaçanikun dhe të gjithë qytetarët tanë. Ju Faleminderit!

Kalojmë në pikën e 8;

## **8. Mbyllja e Mbledhjes**

**Kryesuesi i Kuvendit-Selajdin Troni:** Gjatë muajit dhjetor të këtij viti, do të shqyrtojmë mundësinë të organizojmë një mbledhje, ku do të formohen komitetet obligative të KK: 1. Komiteti për Politikë dhe Financa dhe 2. Komiteti për Komunitete.

Është mirë që për mbledhjen vijuese të përcaktoheni për shifat e grupeve të përfaqësuara në kuvend, në mënyrë që të dihet se kush e merr fjalën në emër të secilit subjekt politik të përfaqësuar në KK. Gjithashtu duhet të shikoni me IT çështjen e hapjes se emaileve zyrtare. Besoj se anëtarët e KK do të pajisen me mjete pune- laptop, në mënyrë që të shërbeheni në materialin e mbledhjes, i cili iu dërgohet në formë elektronike.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu që e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora: 11:51.

Ju faleminderit për pjesëmarrje!

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

Kryesuesit e mbledhjes:  
1. Xhelal Dema \_\_\_\_\_  
2. Selajdin Troni \_\_\_\_\_



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**  
**Sektori i Kuvendit--**

**01Nr. 60/01-29454/2025**  
**Kaçanik, 08.12.2025**

### **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja Inauguruese (Konstituive) e Kuvendit të Komunës (KK) Kaçanik, mbajtur më 08 Dhjetor 2025.

Mbledhja u mbajt në katin e III (Tretë) të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 10:00.

Pjesëmarrës;

- 21 Anëtarë e zgjedhur të Kuvendit të Komunës,
- Kryetari i zgjedhur i komunës, Sabedin Vishi,
- Drejtorët aktual të drejtorive komunale,
- Zyrtarë komunal,
- Përfaqësuesi nga OSBE-së, Faruk Dërmaku,
- Përfaqësues nga KKZ-së, Artan Mezraja,
- Përfaqësues nga KFOR-i
- Përfaqësues nga shoqëria civile (OJQ), përfaqësues tjerë,
- Mysafirë të ftuar,
- Qytetarë të komunës.

Mbledhjen e ka ftuar Kryetari i zgjedhur i Komunës, Sabedin Vishi, Ndërkaq e udhëheqë anëtari me i vjetër i KK, Xhelal Dema.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, ZLPKK.

Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë. Nga MAPL, mbledhja monitorohet nga distanca nga zyrtari, Nehat Uka.

Fillimisht të gjithë anëtarët e zgjedhur të KK që e marrin mandatin, e nënshkruan Listën e pjesëmarrjes në mbledhje të KK (ashtu siç është paraparë në pikën 1 të rendit të punës).

**Para se me filluar mbledhja u ekzekutua Himni i Flamurit të Republikës së Kosovës**

Pas ekzekutimit të himnit, anëtari me i vjetër në moshë i Kuvendit të Komunës, Xhelal Dema, e hapi mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës, data 08 dhjetor 2025. Fillimisht mbajti një fjalë mirëseardhëse.

**Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës, Xhelal Dema:**

Zonja dhe Zotërinj, të nderuar anëtarë të zgjedhur të Kuvendit të Komunës së legjislaturës së 8, i nderuar kryetar i zgjedhur i komunës së Kaçanikut, Sabedin Vishi, të nderuar të pjesëmarrës të kësaj mbledhje,

Mirë se keni ardhur në mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të Komunës, të legjislaturës së tetë (8), data 08 dhjetor 2025.

Fillimisht shfrytëzoj rastin t'i përshëndes, përfaqësuesit e strukturave ndërkombëtare, KFOR, OSBE, zyrtarët e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që monitorojnë mbledhjen, KFOR-in, familjet e dëshmorëve, shoqatat e dala nga lufta e UÇK, Komisioni Komunal Zgjedhor, qytetarët e komunës së Kaçanikut, mediat, përfaqësuesit e shoqërive civile dhe pjesëmarrësit tjerë.

Njëherë i përshëndes anëtarët e zgjedhur të Kuvendit të Komunës që kanë fituar ulëse në Kuvendin e Komunës si rezultat i zgjedhjeve lokale të datës 12 tetorit 2025. E përshëndes Kryetarin e zgjedhur të komunës së Kaçanikut, Sabedin Vishi që ka fituar në rundin e dytë të votimit me 09 Nëntor 2025 për me udhëhequr me Komunën e Kaçanikut.

Në këtë mbledhje do të bëhet Inaugurimi i dy organeve me të larta të Komunës së Kaçanikut;

1. Kuvendi i Komunës – organi me i lartë vendimmarrës i komunës, dhe
2. Kryetari i Komunës, organit më i lartë ekzekutiv i komunës.

Sipas nenit 42.5 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, mbledhjen Inauguruese të Kuvendit të komunës e udhëheqë anëtari më i vjetër i kuvendit, deri më zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, që në këtë rast anëtari me i vjetri në moshë jam unë, XHELAL DEMA nga subjekti politik i PDK.

### **Për këtë takim është propozuar ky Rend Pune**

1. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës;
2. Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës;
3. Dhënia e Betimit Solemn e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës;
4. Dhënia e Betimit Solemn e Kryetarit të zgjedhur të Komunës;
5. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës;
6. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
7. Fjala përshëndetëse e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës; dhe
8. Mbyllja e mbledhjes.

Kuorumi ekziston për të u mbajtur mbledhja, Procesverbalin e mbledhjes do ta mbajë zyrtarja e kuvendit, znj. Makfire Malsiu.

Fillojmë më rendin e punës;

#### **Pika 1**

1. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës;  
Fillimisht anëtarët e zgjedhur të KK e kanë nënshkruar listën për pjesëmarrjen e tyre. kështu që kjo pikë është përfunduar.

### Pika 2

2. Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës;  
Kjo pikë përfundoj me fjalën time mirëseardhëse të cilën e mbajta në fillim të mbledhjes.

### Pika 3

#### **3. Dhënia e Betimit solemn e anëtarëve të Kuvendit të Komunës**

Para se të fillojmë me ceremoninë e betimit, u njoftoj se anëtarët e kuvendit të komunës që nuk e japin dhe nënshkruajnë betimin solemn brenda afatit prej 1 (një) muaj ditë nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut i legjislaturës së 8, është në përbërje prej 21 anëtarë, përfaqësohet nga 5 subjekte politike, me fitim të mandateve si vijon:

1. PDK- Partia Demokratike e Kosovës, 8 mandate;
2. LVV- Lëvizja Vetëvendosje, 6 mandate,
3. LDK- Lidhja Demokratike e Kosovës, 3 mandate,
4. Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut, 3 mandate,
5. AAK- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, 1 mandat.

Flet betimet u janë shpërndarë të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së bashku më Ftesën për mbledhje. Po e lexoj listën e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës, të certifikuar nga KQZ me 21.11.2025: Nga lista e anëtarëve të certifikuar, Besim Ilazi-PDK e ka dorëzuar mandatin, ndërkaq është zëvendësuar me vendim të KQZ me kandidatin e radhës nga PDK- Blerim Koxha. Jeton Raka-LVV e ka dorëzuar mandatin, ndërkaq është zëvendësuar me vendim të KQZ me kandidatin e radhës nga LVV- Enis Vishi. Në vazhdim e lexoj regjistrin e anëtarëve të KK cilët kanë nënshkruar listë për pjesëmarrje për me dhënë betimin për anëtar të KK.

| <b>REGJISTËR I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS</b><br><b>nga Mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës, të datës 08.12.2025</b> |                         |                            |                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|----------------------------|-------------------|
| <b>1</b>                                                                                                                          | <b>2</b>                | <b>3</b>                   | <b>5</b>          |
| <b>Nr. Rend.</b>                                                                                                                  | <b>Emri dhe Mbiemri</b> | <b>Përkatësia Politike</b> | <b>Nënshkrimi</b> |
| 01.                                                                                                                               | Blerim Koxha            | PDK                        |                   |
| 02.                                                                                                                               | Xhelal Ceka             | PDK                        |                   |
| 03.                                                                                                                               | Selajdin Troni          | PDK                        |                   |
| 04.                                                                                                                               | Xhelal Dema             | PDK                        |                   |
| 05.                                                                                                                               | Bashkim Krasniqi        | PDK                        |                   |
| 06.                                                                                                                               | Lejla Muhaxheri Çaka    | PDK                        |                   |
| 07.                                                                                                                               | Dardana Tafili Dauti    | PDK                        |                   |
| 08.                                                                                                                               | Shqipe Murseli          | PDK                        |                   |
| 09.                                                                                                                               | Enis Vishi              | LVV                        |                   |
| 10.                                                                                                                               | Kadrije Lika Troni      | LVV                        |                   |
| 11.                                                                                                                               | Ernesta Krasniqi        | LVV                        |                   |
| 12.                                                                                                                               | Islam Gashi             | LVV                        |                   |
| 13.                                                                                                                               | Buletin Guri            | LVV                        |                   |
| 14.                                                                                                                               | Jeton Luma              | LVV                        |                   |
| 15.                                                                                                                               | Betim Shala             | LDK                        |                   |
| 16.                                                                                                                               | Samedin Rexha           | LDK                        |                   |
| 17.                                                                                                                               | Ardita Rrahmani         | LDK                        |                   |
| 18.                                                                                                                               | Heset Malsiu            | VZHK                       |                   |

|     |                |      |  |
|-----|----------------|------|--|
| 19. | Kijani Zeneli  | VZHK |  |
| 20. | Lejla Luta     | VZHK |  |
| 21. | Hafize Sallahi | AAK  |  |

Nëse jeni të pajtimit shkojmë me ceremoninë e betimit të anëtarëve të kuvendit të komunës. Me këtë rast, i ftoj të gjithë pjesëmarrësit e kësaj mbledhje që në shenjë respekti për betimin e anëtarëve të kuvendit të komunës, të ngritën në këmbë, ndërkaq të gjithë anëtarët e zgjedhur të kuvendit të komunës, që mendojnë të marrin përsipër detyrën e anëtarit të kuvendit të lexojnë tekstin e “Betimit Solemn” të përcaktuar si në nenin 35.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Unë do ta lexoj tekstin e betimit, ndërkaq ju e përsërisni çdo fjalë që unë e lexoj:

**“Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e më ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.**

Anëtarët e Kuvendit të Komunës të cilët e dhanë betimin, duhet të nënshkruajnë Fletë betimin dhe t’ia dorëzoni Sekretarisë së Kuvendit.

**Me këtë rast Konstatohet se u INAUGURUA Kuvendi i Komunës Kaçanik -organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i dalë nga zgjedhjet lokale të datës 12 tetorit 2025.**

Më lejoni të iu bëjë më dije se anëtarët e zgjedhur të kuvendit të komunës Kaçanik që e dhanë Betimin dhe e nënshkruan Deklaratën solemne, nga kjo datë e marrin zyrtarisht detyrën e anëtarit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, për mandatit 4 vjeçar.

Urime të gjithë anëtarëve të zgjedhur të kuvendit të komunës, shëndet, suksese, punë të mbarë në aktivitetit e punës së kuvendit të komunës.

#### **Pika 4**

#### **4. Dhënia e Betimit të Kryetarit të zgjedhur të Komunës, Sabedin Vishi;**

**Kryesuesi i mbledhjes, Xhelal Dema:** Me rastin e zgjedhjes, kryetari e jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të kuvendit të komunës.

Sipas nenit 57.2 Kryetari që dështon ta jap betimin brenda një (1) muaj nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve, e humbë mandatin.

E ftoj Kryetarin e zgjedhur të Komunës së Kaçanikut, Sabedin Vishi, të ngritët në këmbë dhe para Kuvendit të Komunës të e lexoj tekstin e betimit solemn të përcaktuar si në nenin 57.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Ndërkaq në shenjë respekti për betimin e Kryetarit të Komunës, i ftoj të gjithë të pranishmit të ngritën në këmbë.

Kryetari i zgjedhur i komunës, Sabedin Vishi e lexoj Teksti i Betimit Solemn si vijon:

**Unë SABEDIN VISHI Betohem(ose deklaroj solemnisht) që do t’i kryej detyrat e mia dhe do të i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Kaçanikut me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim më ligjin, në mënyrë që të siguroj kushte për jetë të qetë për të gjithë”.**

Pas leximit të tekstit të betimit, kërkoj nga Kryetari i Komunës që ta nënshkruaj Fletë betimin, dhe i njëjti i dorëzohet Sekretarisë së kuvendit.

**Më këtë rast, Konstatoj se u INAUGURUA Kryetari i Komunës së Kaçanikut, si organi më i lartë Ekzekutiv i Komunës, i dalë nga zgjedhjet lokale të 12 tetorit 2025 respektivisht nga raundi i dytë i zgjedhjeve me 9 nëntor 2025. Nga kjo datë Kryetari i zgjedhur i komunës- Sabedin Vishi, e merr zyrtarisht detyrën për të udhëhequr me Komunën e Kaçanikut në pajtim me aktet në fuqi.**

Kjo pikë konstatohet se përfundoj më kaq, ndërkaq kryetarit të zgjedhur të komunës i urojmë shëndet, suksese, punë të mbarë në mandatin e tij të zgjedhur, 4 vjeçar, për të udhëhequr me Komunën e Kaçanikut.

**Ceremonia e dorëzimit pranimit të detyrës së kryetarit të komunës do të bëhet pas mbledhjes, në Zyrën e Kryetarit.**

#### **Pika e 5**

### **5. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës;**

**Kryesuesi i mbledhjes, Xhelal Dema:** E ftoj Kryetarin e komunës, Sabedin Vishi për një fjalë përshëndetëse ;

### **Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës, SABEDIN VISHI**

Të nderuara familje të dëshmorëve e martirëve të rënë, invalidë e veteranë të UCK, ish të burgosur politik, drejtues të shoqatave të dala nga lufta, përfaqësues të policisë, KFORIT, MAPL, KKZ, i respektuar kryesues i mbledhjes inauguruese, të nderuar anëtarë të legjislaturës së re të KK, deputet, përfaqësues fetar nga shoqëria civile, media, punonjës të administratës komunale, kaçanikas të dashur, zonja dhe zotërinj

Jam sot përballë secilit qytetarë pran të zgjedhurve, në këtë vend e momentum të shënuar, që me bënë nder e privilegj të veshur me petkun e përgjegjësisë të jem i zgjedhuri i juaj nën udhëheqjen e qytetit tonë të historisë e lavdisë. Kaçaniku, dashurisë tonë të përbashkët. Jam thellësisht mirënjohës për besimin që me keni dhënë, për mbështetjen tuaj, që me keni dhënë shansin që me keni ofruar të shërbejë si kryetar i komunës së Kaçanikut.

Me përulje, nderë e respekt nga zemra, faleminderit dhe përherë mirënjohës. Sot për secilin nga ne është në ditë e veçantë për komunën tonë, është dita kur ne jo vetëm që inaugurojmë një mandat të ri qeverisës, por edhe riafirmojmë vizionin, shpresën dhe vullnetin e qytetarëve të Kaçanikut për një të ardhme me të mirë. Ky besim nuk është privilegj, është përgjegjësi dhe unë jam sot para jush me zotimin e plotë se do të ushtoj këtë përgjegjësi me ndershmëri, përkushtim dhe transparencë. Nga këtu nga kjo sallë e KK, zotohem se do të jam konstruktiv, bashkëpunues me të gjitha grupet politike të përfaqësuara në KK, sepse në fund të gjithëve na bashkon një qëllim, mirëqenia e qytetarëve të komunës tonë. Përkujdesja institucionale nuk do të mungoj për asnjë kategori, e në veçanti kategorive të dala nga lufta ndaj vlerave të UÇK, ndaj familjeve të dëshmorëve, invalidëve e veteranëve të luftës që janë pjesa me e ndjeshme dhe me e çmueshme e historisë dhe lirisë sonë. Në këtë mandat, prioritetet tona do të jenë të qarta, zhvillimi ekonomik përmes mbështetjes së ndërmarrjeve vendore, të rinisë dhe investimeve të jashtme përmes subvencioneve e formave të ndryshme afirmative, infrastrukturë moderne, që iu përgjigjet nevojave reale të qytetarëve tanë, dhe që i hap dyert e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Arsimin dhe rininë, sepse e ardhmja e Kaçanikut ndërtohet duke krijuar mundësinë për rininë që të krijojnë e lulëzojnë në e

kontribuojnë në vendin e tyre. Shëndetësi dhe mirëqenie sociale, me shërbime me efikase, humane me të afërta për qytetarin e Kaçanikut. Qeverisje transparente dhe administratë efikase, ku çdo vendim merret me përgjegjësi dhe në sytë e publikut, ku qytetari është partneri ynë në vendimmarrje, por jemi të vetëdijshëm që këtë rrugëtim do të ndërtojmë së bashku, sepse as nuk mundemi dhe as nuk dëshirojmë të qeverisim vetë, duke vazhduar urat e krijuara të bashkëpunimit ndërinstitutionale me institucionet qendrore e lokale, me bizneset, me shoqërinë civile dhe mbi të gjitha, me ju qytetarë të Kaçanikut. Unë jam këtu për t'iu dëgjuar, për t'iu shërbyer dhe për të punuar krah për krah me ju. Me lejoni të shpreh një falënderim të veçantë për kryetari, z. Besim Ilazi, i cili mbi një dekadë iu shërbeu qytetarëve të Kaçanikut në mënyrë dinjitoze, transparente e llogaridhënëse, po ashtu kryesuesin e deritanishëm, z. Kemal Murseli dhe të gjithë anëtarët tjerë të KK të legjislaturës së kaluar, për kontributin e dhënë gjatë atij mandati. Faleminderit bashkëpunëtorëve të mijë nga të gjithë oponentët politik për rrugën e drejtë që po realizojmë së bashku. Faleminderit familjes time për mbështetjen time dhe mirëkuptimin në çdo hap, në çdo hap. Ju falënderoj nga zemra për këtë nder dhe përgjegjësi. Zoti e bekoftë Kaçanikun dhe gjithë qytetarët e tij, faleminderit, na priftë e mbara së bashku.

### **Pika e 6**

#### **6. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;**

**Kryesuesi i mbledhjes, Xhelal Dema:** U njoftoj se Procedura për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit është e rregulluar me nenin 41 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe Udhëzimin Administrativ 2009/1 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Udhëzimin Administrativ e keni marrë. Udhëzimin e keni marrë nga Sekretaria e KK. Sipas nenit 2.2 të këtij Udhëzimi, secili subjekt politik, nismë qytetarësh apo kandidat i pavarur i përfaqësuar në kuvend ka të drejtë që nga radhët e anëtarëve të kuvendit të propozoj një anëtar për Kryesues të Kuvendit të Komunës.

Gjatë kësaj pike, mbledhjen e lëshua tre (3) anëtarët nga LDK (Betim Shala, Samedin Rexha, Ardita Rrahmani). Mbledhjen e lëshuan edhe tre (3) anëtarët nga Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut (Heset Malsiu, Kjani Zeneli, Lejla Luta). Prezentë në sallë mbetën 15 anëtarë, 8, anëtarët nga PDK, 6 anëtarët nga LVV dhe 1-anëtarja nga AAK.

**Kryesuesi i mbledhjes, Xhelal Dema:** Fillimisht kuvendi duhet të formoj një komision për mbarëvajtjen e procesit të votimit.

Nëse nuk ka kush diçka rreth kësaj çështje, atëherë shkojmë më formim të komisionit. A ka kush ndonjë propozim konkret për përbërjen e komisionit, nëse ka atëherë shkojmë më propozimin për përbërje të komisionit prej 3 anëtarëve. Shkojmë me propozime konkrete për anëtarë të komisionit, duke filluar subjekti me i madh politik nga PDK

**znj. Dardana Tafili Dauti:** Përshëndetje për të gjithë, urime detyra e re kryetarit të komunës, Sabedin Vishi dhe anëtarëve të kuvendit -kolegë asambleistë. Për anëtar të komisionit nga PDK e propozojmë të jetë, Bashkim Krasniqi.

**Kryesuesi i mbledhjes, Xhelal Dema:** Nga LVV, kërkoj një propozim për anëtar të komisionit.

**znj. Kadrije Lika Troni:** Përshëndetje të pranishëm, përshëndetje edhe për ju kolegë asambleistë, urime për mandatin e ri, shëndet dhe mbarësi në vazhdimësi. Ne si grup i LVV propozojmë për anëtare të komisionit të jetë, Ernesta Krasniqi.

**Kryesuesi i mbledhjes, Xhelal Dema:** LDK dhe VZHK, nuk janë prezentë, atëherë kërkoj nga AAK një propozim për anëtar të komisionit.

**znj. Hafize Sallahu:** Fillimisht i përshëndeti të gjithëve, urime për kryetarin e sapo zgjedhur. Uroj të shkoj mbarë puna për 4 vitet e ardhme. Po ashtu i përshëndeti edhe kolegët e mi asambleistë. Meqë unë jam e vetme nga AAK, do të jam unë anëtare e komisionit.

**Kryesuesi i mbledhjes, Xhelal Dema:** Për anëtarë të komisionit u propozuan:

- 1.Bashkim Krasniqi,
- 2.Ernesta Krasniqi,
- 3.Hafize Sallahi.

Atëherë, propozimet e dhëna për anëtarë të komisionit i shtroj në votim, dhe u aprovuan njëzëri. Prezentë 15. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës, mori

#### V E N D I M

**Për formimin e komisionit për zbatimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës, në përbërje:**

- 1.Bashkim Krasniqi-PDK
- 2.Ernesta Krasniqi-LVV
- 3.Hafize Sallahi-AAK.

Para se me proceduar me kandidatë për Kryesues të KK, Kryesuesi i mbledhjes, Xhelal Dema kërkoj nga publiku që nëse dikush nuk është i interesuar me qëndruar në sallë, mundet me dalë, pasi u krye ceremonia e betimit e anëtarëve të KK dhe ceremonia e betimit e kryetarit të Komunës.

**znj. Dardana Tafili Dauti:** Kërkoj të bëhet një pauzë e Kuvendit të Komunës prej 15 minutave.

**Kryesuesi i mbledhjes, Xhelal Dema:** Meqenëse anëtarët nga LDK dhe VZHK, e lëshuan mbledhjen, kërkoj të bëhet një pauzë prej 10 minutave.

Pas pauzës, Kryesuesi i mbledhjes, Xhelal Dema, konstatoj se nuk mundemi me vazhduar me mbledhjen në mungesë të kuorumit, pasi që 6 anëtarë me herët e lëshuan mbledhjen, ndërkaq edhe 6 anëtarët nga LVV nuk u kthyen në mbledhje, edhe pse provova me i thirrur disa herë me telefon. Në sallë janë vetëm anëtarët nga PDK dhe anëtarja nga AAK, kështu që e ndërpresë mbledhjen në mungesë të kuorumit. Për vazhdimin e mbledhjes të datës 08.12.2025, ju njoftojmë me kohë.

Mbledhja u ndërprerë në ora 11:01 minutë, e cila mbledhje do të vazhdojë ndonjë ditë tjetër.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu

Kryesuesi i mbledhjes  
Xhelal Dema





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komune e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal of Kačanik

01 Nr. 060/01-31222/25  
Kaçanik, 22.12.2025

Në bazë të nenit 51 dhe 52 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 3.1 dhe 2 lidhur me nenin 4, 5 dhe 6.4 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 – për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës,

### PROPOZOJ

Që Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e datës 30 dhjetor 2025, të merr këtë:

### V E N D I M

### PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

- Me këtë Vendim, formohet Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) i Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, si vijon:

|                     |      |                           |
|---------------------|------|---------------------------|
| 1.1. Selajdin Troni | PDK  | Kryesues sipas funksionit |
| 1.2. _____          | PDK  | anëtar                    |
| 1.3. _____          | PDK  | anëtar                    |
| 1.4. _____          | LVV  | anëtar                    |
| 1.5. _____          | LVV  | anëtar                    |
| 1.6. _____          | LDK  | anëtar                    |
| 1.7. _____          | VZHK | anëtar.                   |
- Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa reflekton përfaqësimin e etniteteve politike në Kuvendin e Komunës, duke reflektuar edhe barazinë gjinore.
- Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, sipas funksionit që e ka. Në rastet kur në mbledhjen e komitetit për politikë dhe financa mungon kryesuesi, mbledhja kryesohet nga anëtarë më i vjetër i komitetit.
- Detyrat e Komitetit për Politikë dhe Financa janë të përcaktuara në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020, Statutin e Komunës dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit.
- Anëtarët e KPF nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.
- Kompensimi për punën e Komitetit për Politikë dhe Financa bëhet sipas Ligjit në fuqi për Paga në Sektorin Publik.
- Ky Vendim hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Personelit, Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Selajdin Troni



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-31223/2025  
Kaçanik, 22.12.2025

Në bazë të nenit 51 dhe 53 të Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen e Lokale, të nenit 3.2 lidhur me nenin 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 – për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, të nenit 39.1 të Statutit të Komunës,

### PROPOZOJ

Që Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e datës 30 dhjetor 2025, të merr këtë:

### V E N D I M

#### PËR FORMIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

1. Me këtë Vendim formohet Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës Kaçanik nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe nga përfaqësues të komuniteteve.

2. Komiteti për Komunitete, është në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, si vijon:

|     |       |                      |         |
|-----|-------|----------------------|---------|
| 2.1 | _____ | PKD                  | anëtar  |
| 2.2 | _____ | LVV                  | anëtar  |
| 2.3 | _____ | LDK                  | anëtar  |
| 2.4 | _____ | VZHK                 | anëtar  |
| 2.5 | _____ | OJQ/ Shoqëria civile | anëtar. |

3. Detyrat e Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr. 05/2020, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

4. Mbledhjet i kryeson Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve nga pika 2. e këtij vendimi. Në mungesë të Kryesuesit të Komitetit për Komunitete, mbledhjet i kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.

5. Kompensimi për punën e Komitetit për Komunitete bëhet sipas Ligjit për Paga në Sektorin Publik.

6. Ky Vendim hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë nga autoriteti mbikëqyrës - MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Anëtarët e Komitetit për Komunitete, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Personelit, Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Selajdin Troni





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipal Kačanik

01Nr. 060/01-31225 /25  
Kaçanik, 22.12.2025

Në bazë të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 40.2 (c) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 34.5 të Statutit të Komunës 01Nr. 6/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të nenit 15.1(c) lidhur me nenin 55 të Rregullores 01Nr. 7864/08 për Punë të Kuvendit të Komunës të datës 13.11.2008,

### PROPOZOJ

Që Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e datës 30 dhjetor 2025, të merr këtë:

### VENDIM

#### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2026

1. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026, në përbërje prej 7 anëtarëve, 6 anëtarë do të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe 1 anëtar nga Zyra e Kryetarit të Komunës, si vijon:

|      |                |                  |          |
|------|----------------|------------------|----------|
| 1.1. | Selajdin Troni | PDK              | kryesues |
| 1.2. | _____          | PDK              | anëtar   |
| 1.3. | _____          | LVV              | anëtar   |
| 1.4. | _____          | LDK              | anëtar   |
| 1.5. | _____          | VZHK             | anëtar   |
| 1.6. | Hafize Sallahi | AAK              | anëtar   |
| 1.7. | Makfire Malsiu | Zyra e Kryetarit | anëtar.  |

2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi, do të hartoj Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026 dhe për të njëjtin do t'i zhvilloj procedurat e nevojshme sipas rregullave ligjore në fuqi deri me miratimin nga Kuvendi i Komunës të Planit të punës.

3. Ky Vendim hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë nga autoriteti mbikëqyrës - MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Anëtarët e komisionit, Kryetari i Komunës, Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Selajdin Troni



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS**



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipality of Kaçanik

07 Nr. 104/02 - 31243/25

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

|                                      |                                                                                                                                                                                   |
|--------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>DATË/E</b>                        | <b>22.12.2025</b>                                                                                                                                                                 |
| <b>PËR/ZA/TO:</b>                    | Zyrës së Kuvendit Komunal<br>z.Selajdin Troni -Kryesues i Kuvendit                                                                                                                |
| <b>KOPJE</b>                         | z. Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës                                                                                                                                               |
